



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**

**Njoftim Paraprak Përqendrimi**

**Rasti: Përfitim Kontrolli: TELEKOM SLOVENIJE d.d/IZI MOBIL  
TELEKOMUNIKACIJE d.d**

Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë të “Marrëveshjes për blerjen e asetëve”, të nënshkruar me datë 30 Qershor 2017 nëpërmjet të cilës synohet të realizohet blerja e asetëve të IZI MOBIL Telekomunikacije d.d (“Target”) tek ndërmarrja TELEKOM SLOVENIJE d.d (“Blerësi”).

Ky njoftim bëhet për shkak se Blerësi plotëson kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **TELEKOM SLOVENIJA d.d**, ndërmarrje sllovene, është ndërmarrja kontrolluese përfundimtare e Grupit Telekom Slovenija dhe është e angazhuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve të lidhura me rrjetet (telekomunikacioni) në Slloveni dhe jashtë saj. Shërbimet e telekomunikacionit të ofruara nga Grupit Telekom Slovenija përfshijnë telefoninë zanore fikse dhe të lëvizshme, transmetim fiks dhe të lëvizshëm të dhënash, akses interneti me brez ët gjerë dhe akses në rrjete televizioni.
- **IZI MOBIL Telekomunikacije d.d**, ndërmarrje sllovene, e regjistruar në regjistrin zyrtar për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit të Republikës së Sllovenisë si kontraktues ose operator i shërbimeve të mëposhtme: shërbime zanore në rrjetin telefonik publik, shërbime në lidhje me të dhënat në rrjetin telefonik publik, shërbime me vlerë të shtuar dhe si një rrjet i telefonave celularë me qira (të dhënë me qira).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe c, dhe nenin 12, pika 1 dhe 2, të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**